

VENDIM
Nr. 131, datë 7.4.2023

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1039/4 prot., datë 5.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 74, seria T08P, të shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.9.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 100, datë 20.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.3.2023 dhe 22.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 74, seria T08P, të shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.9.2018, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 14.9.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti